


WEB MAP "IDENTIFIKIMI I TRUPAVE UJORË"

### Krijimi i Web Map në ArcGIS Online

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), ASIG ka ndërtuar një Web Map në platformën Arcgis Online për "Ndërtesat në basenet me rrezik përmbajtje", i cili shërben për të aksesuar ortoimazherinë dhe ndërtesat e ndodhura në basenet lumore me rrezik përmbajtje. Gjithashtu, ka përfunduar dhe Web Map për "Identifikimin e trupave ujqorë", i dedikuar për të gjithë institucionet përfituese të projektit "Shërbimi Satelitor". Ky Web Map përmban informacione në lidhje me indeksin e turbulencës, klorofilit, sedimentin pezull dhe poligonin e trupit ujqor të lumenjve.



### Verifikimi në Terren i Zonës Maminas-Metallë



Në muajin shkurt 2024 përfundoi kontrolli dhe plotësimi i të dhënave në terren, për zonën Maminas - Metallë, për një sipërfaqe prej 18 km<sup>2</sup>, për Hartën Topografike të shkallës 1:2000. Nga kontrolli vizual i materialit hartografik rezultuan, 150 pika për saktësim në terren me tipologji të ndryshme gabimesh si: kategorizim ndërtesash, verifikim tombino, ura e objekte të tjera hidrike, kabina elektrike, emërtime të ndryshme etj.. Sipas manualit për krijimin e hartave topografike të shkallës 1:2000, u pasqyruan edhe elementë të tjerë shtesë, të cilët lidhen me funksionin dhe llojin e ndërtesave, evidentimin e elementëve si: kabina elektrike, transformatorë, burime, lapidarë etj..

## Publikime të Zonave Arkeologjike dhe Qendrave Historike në Gjeoportalin Kombëtar

Qendra Historike, Bashkia Berat

ASIG në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) ka publikuar së fundmi, në Gjeoportalin Kombëtar Vendimet e Këshillit të Ministrave për:


- Zonat arkeologjike të Gradishtës së Selcës, Bashkia Pogradec; qytetit të Sarandës, “Kalasë së Lëkurësit” dhe “Manastirit të 40 Shenjtorëve”, Bashkia Sarandë;
- Qendrat historike dhe zonat mbrojtëse rreth saj në qytetin e Gjirokastrës dhe Beratit.

Informacioni gjeohapësinor për këto shtresa është publikuar në përputhje të plotë me përcaktimet e miraturo me Vendimet e Këshillit të Ministrave: nr. 637, datë 15.11.2023; nr. 730, datë 13.12.2023; nr. 764, datë 20.12.2023 dhe nr. 827, datë 28.12.2023.

Për më tepër informacion të detajuar mbi këto vendime [klikoni këtu](#).




Qendra Historike, Bashkia Gjirokastrë



Zonat Arkeologjike, Bashkia Sarandë





Zona Arkeologjike, Bashkia Pogradec



## Zonat me Rreziqe Natyrore - Zjarret

Në Gjeoportalin Kombëtar të ASIG është publikuar informacioni gjeohapësinor për temën “Zonat me Rreziqet Natyrore - Zjarret”. Ky publikim u realizua në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), dhe përmban informacion për zjarret që kanë ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës së vitit 2022 dhe 2023. Të dhënat e publikuara janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 810 datë 21.10.2020, Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: “Zonat me Rreziqe Natyrore”.

Për të aksesuar këtë shtresë në Gjeoportalin Kombëtar [klikoni këtu](#).



# PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

## Konferenca “NSDI Day 2024”, Shkup, Maqedonia e Veriut

Përfaqësues të ASIG morën pjesë në Konferencën “NSDI Day 2024”, e cila u zhvillua në datat 21 - 22 shkurt 2024, në Shkup të Maqedonisë së Veriut. Në këtë aktivitet stafi i ASIG paraqiti hapat e ndërmarrja në zhvillimin e NSDI në vendin tonë, përmbushjen e objektivave sipas fushave strategjike duke përfshirë Gjeoportalin, GIS-in Kombëtar, KRGJSH, si dhe evidentimin e risive të fushës së gjeoinformacionit mbi monitorimin e territorit me teknologji të avancuar, projektet dhe planet për të ardhmen e zhvillimit të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor në Shqipëri.



## BOTA E GJEONFORMACIONIT

### EuroGeographics publikon Vlerën e të Dhënave Zyrtare Kombëtare Gjeohapësinore përmes katër rasteve studimore, midis të cilave dhe Shqipëria

EuroGeographics ka publikuar së fundmi katër raste studimi nga Shqipëria, Spanja, Gjermania dhe Islanda, të cilat tregojnë vlerën e informacionit zyrtar gjeohapësinor për vlerësimin e riskut nga përmytjet, erozioni, parandalimi i ndikimit të motit ekstrem, si dhe kontributin në bazën e re evropiane për monitorimin e mbulimit të tokës dhe përdorimin e saj. Të dhënat e Shqipërisë, të vëna në dispozicion nga ASIG ishin thelbësore për vlerësimin e riskut të përmytjeve dhe ndikimit të tij ekonomik në basenin e lumit Drin.

### Kompania SimActive përdor kamerat e pjerrëta për hartat 3D

SimActive, një zhvillues i softuerit të fotogrametrisë, hodhi në treg produktin Correlator3D me drone me multi-kamera për përmirësimin e hartave 3D. Ky program i lejon përdoruesve të importojnë konfigurime të pjerrëta dhe nadir të kamerës për të zhvilluar produkte më të mira të hartave 3D. Pajisja e dronëve me shumë kamera, si p.sh. Oblique D2M nga kompania Quantum-Systems, u mundëson ndërtuesve të hartave të krijojnë teksturat anësore të ndërtesave dhe infrastrukturës.

### SHBA hapin Qendrën e Inteligjencës Gjeohapësinore 24/7

Agjencia Kombëtare e Inteligjencës Gjeohapësinore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (NGA) ka hapur një qendër operacionale 24/7 për të ofruar inteligjencë gjeohapësinore të dedikuar për politikëbërësit dhe forcat ushtarake amerikane në mbarë botën. Kjo agjenci do t’ju ofrojë produkte të dallueshme vizuale dhe informacione gjeohapësinore, vendimmarrësve ushtarakë dhe civilë, në mënyrë më të zgjeruar dhe të vazhdueshme.

## AKTIVITETE NË VIJIM

### Munich Satellite Navigation Summit

Qeveria gjermane në bashkëpunim me ekipin e Navigimit të Hapësirës Ajrore dhe Satelitore organizon në Mynih, Samitin e Navigimit Satelitor, i cili synon t’ju ofrojë pjesëmarrësve një pasqyrë të gjerë dhe këndvështrime të ndryshme mbi zhvillimet më të fundit në fushën e GNSS, si dhe të stimulojë krijimin e aplikacioneve dhe shërbimeve të teknologjisë së lartë.

20-22 Mars 2024

[www.asig.gov.al](http://www.asig.gov.al)

### Cybersecurity for the Space Industry

Kompania Cysec organizon në Paris të Francës, një aktivitet për Sigurinë Kibernetike të Industrisë Hapësinore. Ky aktivitet mbledh komunitetet e sigurisë kibernetike dhe hapësirës për të rritur ndërgjegjësimin për sigurinë kibernetike të aseteve dhe të dhënave hapësinore, në një ekosistem evropian që po përballet me rritje të kërcënimeve të sofistikuar kibernetike.

24-25 Prill 2024

### International Geoscience and Remote Sensing Symposium (IGARSS)

IGARSS 2024 Simpoziumi Ndërkombëtar i Gjeoshkencës dhe Remote Sensing", do të zhvillojë një aktivitet 6 ditor, në Athinë të Greqisë. Ky aktivitet do të kontribuojë në shkëmbimin e pikëpamjeve, përvojave dhe trajnimit të shkencëtarëve të rinj, duke hapur perspektiva të reja për zhvillimin e kërkimit dhe investimet në këtë sektor.

7 - 12 Korrik 2024

[www.geoportal.asig.gov.al](http://www.geoportal.asig.gov.al)